



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.45/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare Për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.45/2025 e datës 18.09.2025.
- II. Subjektit politik Iniciativa Qytetare Për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i më gjobë në lartësi prej 1500€.
- III. Detyrohet Subjekti politik Iniciativa Qytetare Për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 18.09.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 18.09.2025, kandidati për Kryetar të Skenderajt, Sokol Halili, nga subjekti politik “Nisma Qytetare për Skenderaj”, në rrjetin social Facebook, ka postuar një shkrim që përmban gjuhë kërcënuese, fyese dhe nxitje të urrejtjes ndaj kandidatit të PDK-së për kryetar të kësaj Komune, Sami Lushtaku, e cila shkruan “(...) *Bashke kundër çdo krimineli apo argati të armikut tone shekullor serbe unë armike kam vetëm Milan Radoiqiqin dhe shokun e Tina Sami Lushtakun te tjerët janë viktima i hapur për gjithë Drenicaket përjashtim Sami Lushtaku*”. Të tutje, më ankesë theksohet se Sokol Halili përdor një gjuhë të ashpër dhe fyese, duke përdorur shprehje si “*kriminel*”, “*argat i armikut*”, si dhe duke bërë krasime denigruese mes Sami Lushtakut dhe Milan Radojcit, një person i njohur për veprimtarinë kriminale dhe për lidhjen me strukturat paralele serbe në veri të Kosovë, duke shtuar se këto shprehje jo vetëm që përbejnë fyerje personale, por përbejnë edhe elemente të qartë të gjuhës së urrejtjes, të cilat mund të konsiderohen si nxitje ndaj dhunës dhe përçarje

mes qytetarëve, duke theksuar se këto deklarime janë veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se vijnë nga kandidat për një funksion publik i cili duhet të shërbej si shembull i përgjegjshmërisë dhe respekti ndaj kundërshtarëve politikë.

Me këtë sipas parashtruesit te ankesës është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 i cili shprehimisht thotë: “*përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.*” Si provë ka bashkëngjitur fotografinë e postimit nga llogaria sociale Facebook e kandidatit për kryetar Sokol Halili.

Në përgjigje në ankesë Kandidati i Iniciativës Qytetare për kryetar te komunës Skenderaj, Sokol Halili ka kundërshtuar pretendimet e parashtruesit të ankesës, duke theksuar se nuk i ka bërë të padrejtë dhe nuk ka shpifur ndaj askujt.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, të cilat janë bërë nga Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, nga e cila rrjedh se kandidati për kryetar të Skenderajt nga subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj Sokol Halili, përmes llogarisë së tij në rrjetin social Facebook ka deklaruar “*(...) Bashke kundër çdo krimineli apo argati të armikut tone shekullor serbe unë armike kam vetëm Milan Radoiqiqin dhe shokun e Tina Sami Lushtaku te tjerët janë viktima i hapur për gjithë Drenicaket përjashtim Sami Lushtaku*”, gjen se e njëjta është e bazuar, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërrës si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”, andaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga kandidati i Iniciativës Qytetare për Skenderaj Sokol Halili, ndaj kandidatit për kryetar te Komunës e Skenderajt të PDK-së Sami Lushtaku në fushatë zgjedhore dhe përdorimi i termave *kriminel dhe argat i armikut* kundrejt kandidatëve

tjerë, si dhe kahasimet e kandidatëve me persona *me precedentë penale*, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika I.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është dhënë deklarata në rrjetin social Facebook, prandaj, sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim nxitje të dhunës dhe urrejtjes. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fye, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga Iniciativa Qytetarë për Skenderaj, kandidati Sokol Halili, sipas Panelit është shkelje e etikës zgjedhore dhe standardeve të sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejtë. PZAP-i me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se nxit dhunë dhe urrejtje politike.

Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që janë përdorur mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt, duke shkelur kështu parimet e një fushatë pozitive dhe të respektueshme.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje përkatësisht faktin se i njëjtë subjekt në këtë fushatë zgjedhore nuk është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes. Në lartësinë e gjobës Paneli ka marrë për bazë faktin se Iniciativa Qytetarë në fjalë, nuk është përfitues i Fondit për Financimin e Subjekteve Politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika I.11), nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 45/2025 më datë 20.09.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.